



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Nëntor 2021

Nr. 467

**VENDIM**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në datën 21.09.2021 në përmbushje të vendimit nr. 107, datë 26.7.2021, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi riçeli hetimin administrativ të çështjes që u përket:

**Kërkues:** Organizata “Qëndresa Qytetare”

**Ndaj:** Z. Alqi Bllako  
Bashkisë Tiranë  
Bibliotekës “Moikom Zeqo”  
Partisë Socialiste e Shqipërisë

**Objekti i ankimit:** Për rishqyrtimin administrativ të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në lidhje me zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet e bibliotekës “Moikom Zeqo”, me pjesëmarrjen e kandidatit për deputet z. Alqi Bllako

**Baza ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, nenin 21, shkronja “dh”, neni 91 dhe neni 172, pika 1, të ligjit nr. 10019, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

**I. Rrethanat e faktit**



Data: 11 Nëntor 2021  
Nr. 467

Për rishqyrtimin administrativ të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në lidhje me zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet e bibliotekës “Moikom Zeqo”, me pjesëmarrjen e kandidatit për deputet z. Alqi Bllako

- Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve, në datën 19.03.2021, është raportuar nga Organizata “Qëndresa Qytetare” denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2368, ndaj kandidatëve për deputetë të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Bllako dhe Bashkisë Tiranë. Denoncuesi pretendon se në shkelje të nenit 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, zj. Kledina Skëndo, ditën e enjte në datë 18 Mars 2021, në ambientet e bibliotekës së qytetit të Tiranës, “Misto Treska”, ka zhvilluar takim me mbështetësit në prani të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj. Gjithashtu në datën 11 Mars në ambientet e të njëjtës bibliotekë, kandidati për deputet z. Alqi Bllako, i subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zhvilloi takim me mbështetësit e Partisë Socialiste. Organizata “Qëndresa Qytetare” denoncon shkeljen e nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, neni 3, pika “c”, ku në dispozicion të kandidatëve pretendon se janë vendosur asetet e publike, konkretisht ambientet e Bibliotekës “Misto Treska”. Në cilësinë e provës Organizata “Qëndresa Qytetare”, ka vendosur në dispozicion dy link-e të rrjetit social “Facebook”, në të cilin sipas saj, gjenden provat e këtij aktiviteti.

Linku: <https://www.facebook.com/ErionVeliaj/videos/475327973499543>

Linku: <https://www.facebook.com/alqibllako/photos/pcb.249855103500745/249854930167429/>

- Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 3503 prot., datë 09.04.2021, i ka kërkuar, Bashkisë Tiranë informacion sqarues në lidhje me zhvillimin e këtyre aktiviteteve.
- Duke qenë se Bashkia Tiranë, brenda afateve të përcaktuara ligjore, nuk i ktheu përgjigje kërkesës tonë, kushtëzuar nga afati përcaktuar në vendimin nr. 9/2021 të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendosi të shtyjë hetimin administrativ deri në një përgjigje të Bashkisë Tiranë, për çështjen në fjalë. Me vendimin nr. 361, datë 19.05.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- Me shkresën nr. 1444/1 prot., datë 14.05.2021, protokolluar me tonën me nr. 5371 prot., datë 19.05.2021, Administratorja e Njesisë Administrative nr. 10, zj. Karolina Kostallari, bën me dije se në bibliotekën “Misto Treska”, e cila ndodhet në administrimin e kësaj njësie, zhvillohen shpesh evenimente dhe aktivitete të karakterit social, kulturor dhe informues për banorët e Njesisë dhe më gjerë, por në asnjë rast nën menaxhimin dhe monitorimin e kësaj njësie nuk është zhvilluar asnjë aktivitet i karakterit zgjedhor, kjo dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë, nr. 35, datë 29.03.2018 “Bibliotekat e lagjeve si qendra multifunkionale”.



- Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku paraqitur nga palët si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ, çmoi se pretendimi i kallëzuesit, Organizata “Qëndresa Qytetare”, për shkelje të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator nga ana e Bashkisë Tiranë, nëpërmjet vendosjes së aseteve publike në dispozicion të kandidatëve për deputetë zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Bllako, është i pabazuar në prova dhe fakte. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 424, datë 12.07.2021, vendosi: “Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj bashkisë Tiranë, për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ”.
- Kundër këtij vendimi, Organizata “Qëndresa Qytetare”, në datën 22.07.2021, ka paraqitur ankim, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) i cili, me vendimin nr. 107, datë 26.07.2021, vendosi:
  1. Shfuqizimin e vendimit nr. 424, datë 12.07.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
  2. Riçeljen e hetimit administrativ të plotë e të gjithanshëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Kodin e Procedurave Administrative.

## 2. Riçelja e hetimit administrativ

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në respektim të vendimit të KAS nr. 107, datë 26.07.2021, ditën e premte, më datë 17.09.2021, ora 12:00, në përputhje me përcaktimet e neneve 47 dhe 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, riçeli hetimin administrativ të plotë e të gjithanshëm për të garantuar të drejtat e palëve në proces administrativ, duke zhvilluar një seancë dëgjimore, në të cilën u thirrën palë: Organizata “Qëndresa Qytetare”, zj. Kledina Skëndo, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe z. Alqi Bllako, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Bashkia Tiranë, përfaqësues të bibliotekës “Misto Treska” si dhe subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.



- Në seancën dëgjimore i pranishëm ishte përfaqësuesi i Organizatës “Qëndresa Qytetare” si dhe kandidati për deputet i subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zj Kledina Skëndo. Palët e tjera nuk u paraqitën në seancë dëgjimore.
- Përfaqësuesi ligjor i Organizatës “Qëndresa Qytetare”, rikonfirmoi pretendimet e tij për përdorimin e bibliotekës “Misto Treska”, duke pretenduar se: *“Është shkelur haptazi Kodi Zgjedhor si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2012, i Komisionit Rregullator, sipas të cilit ndalohet përdorimi i aseteve publike për aktivitete të fushatës elektorale. Sipas tij, biblioteka e Tiranës është nën administrimin e bashkisë Tiranë dhe janë asete publike të administruara dhe në pronësi të Bashkisë Tiranë. Është provuar nëpërmjet pamjeve filmike dhe provave fotografike, të marra nga rrjeti social “Facebook”, se kjo bibliotekë është vënë në dispozicion të kandidatit për deputet për kryerjen e aktivitetit elektorale”*.
- Organizata “Qëndresa Qytetare” ka depozituar gjithashtu kërkesën me nr. 6174 prot., datë 29.07.2021, në të cilën ka paraqitur si provë shtesë, linkun e FB të ATSH-së:  
Link: [https://www.facebook.com/ëatch/live/?v=949198432555609&ref=ëatch\\_permalink](https://www.facebook.com/ëatch/live/?v=949198432555609&ref=ëatch_permalink)  
si dhe ka kërkuar zgjerimin e objektit të kallëzimit duke pretenduar edhe shkeljen e nenit 172 të Kodit Zgjedhor nga subjekti politik “Partia Socialiste” si dhe shtimin e saj si palë të akuzuar në përputhje me nenin 172 të Kodit Zgjedhor.
- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më datë 07.10.2021, zhvilloi një tjetër seancë dëgjimore, në kuadër të riçeljes së hetimit administrativ. Gjatë seancës dëgjimore Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi: ndarjen e çështjeve për shkak se Organizata “Qëndresa Qytetare”, në lidhje me zhvillimin e aktivitetit elektorale të kandidatit për deputet z. Alqi Bllako, kërkoi ndryshimin e vendndodhjes së kryerjes së këtij aktiviteti nga biblioteka “Misto Treska, në bibliotekën “Moikom Zeqo”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vijoi hetimin administrativ, nëpërmjet shkresës nr. 6842 prot., datë 04.11.2021, duke njoftuar z. Florian Pullazi, Administrator i Njesisë Administrative nr. 2, Tiranë, i cili ka nën përgjegjësi administrimi bibliotekën “Misto Treska”, kandidatin për deputet të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë z. Alqi Bllako, Kryetarin e Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj, Partinë Socialiste të Shqipërisë si dhe kallëzuesin Organizata “Qëndresa Qytetare”. Secila nga palët u njoftua për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 11.11.2021, për të parashtruar argumentet dhe pretendimet mbi denoncimin e Organizatës “Qëndresa Qytetare”.



### 3. Analiza e fakteve dhe provave

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më datë 11.11.2021, zhvilloi seancën dëgjimore, ku të pranishëm z. Florian Pullazi, në cilësinë e Administratorit të Njesisë Administrative nr. 2, i cili ka nën administrim të tij dhe bibliotekën “Moikom Zeqo” si dhe përfaqësues të Organizatës “Qëndresa Qytetare”.
- Përfaqësuesi ligjor i Organizatës “Qëndresa Qytetare”, i qëndron pretendimeve të mëparshme.
- Z. Florian Pullazi, Administrator i Njesisë Administrative nr. 2, Tiranë, deklaroi se *“Biblioteka është qendër multifunkionale, ku mund të ushtrojnë aktivitet organizata, banorë të njesisë administrative etj. Bibliotekat janë të hapura për publikun dhe në dijeninë time, kjo bibliotekë nuk është vënë në dispozicion të asnjë kandidati për deputet, për të kryer aktivitet apo fushatë elektorale. Brenda Bibliotekës “Moikom Zeqo”, asnjëherë nuk është kryer aktivitet i natyrës politike apo elektorale. Biblioteka vazhdimisht shfrytëzohet për aktivitete të natyrave të ndryshme”*.

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se:

- Në bibliotekën “Moikom Zeqo” është zhvilluar një aktivitet me natyrë zgjedhore me votuesit për herë të parë të njesisë administrative nr.2, në Tiranë, me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj si dhe kandidatit për deputet z. Alqi Bllako, të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Nga provat e vëna në dispozicion, konstatohet se pjesëmarrësit kanë zhvilluar fushatë elektorale.
- Sipas parashikimeve të nenit 33.2, pika 6, të vendimit nr. 25661, datë 02.07.2018 “Për një ndryshim të rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”, *“Administratori i Njesisë Administrative siguron një mirëadministrim të këndeve të lojrave, terreneve sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë”*.
- Administratori i Njesisë Administrative, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve, ka lejuar zhvillimin e një veprimtarie me qëllim zgjedhor në mbështetje të kandidatit për deputet mjediset e bibliotekës “Moikom Zeqo”, e cila përbën aset të paluajtshëm, burim të organit publik, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Konstatohet se ndodhemi përpara shkeljes për përdorimin e aseteve publike për qëllime zgjedhore, pavarësisht faktit se biblioteka është një qendër multifunkionale. Duhet që nga ana e Bashkisë apo Njesisë Administrative të ketë një rregullim mbi këtë çështje, duke parashikuar qartazi nëse këto asete publike mund të vendosen në dispozicion



të kandidatëve të subjekteve politike për veprimtari elektorale. Në kushtet kur ndodhemi përpara kësaj shkelje dhe nuk ka një rregullim ligjor nga ana e Bashkisë apo Njesisë Administrative, me përgjegjësi ngarkohen personat që kanë nën administrim këtë aset publik.

- Në kuptim të nenit 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor, subjektet zgjedhore ndëshkohen administrativisht në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, me parakushtin që subjekti zgjedhor, të ketë marrë djeni dhe pas marrjes djeni të mos ketë marra masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Në rastin objekt shqyrtimi, nuk u provua që subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, të jetë vënë në djeni.

Për sa më sipër, përgjegjësia administrative i atashohet personave që kanë për detyrë mirëadministrimin e këtij asemi në përputhje me parashikimet e ligjit dhe akteve nënligjore duke u përjashtuar nga përgjegjësia partia politike apo kandidatit për deputet që mund të ketë kryer këtë aktivitet.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, nenin 21, shkronja “dh”, nenin 91, dhe nenin 172, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### **V E N D O S:**

1. Konstatimin e shkeljes nga ana e z. Florian Pullazi, Administrator i Njesisë Administrative nr. 2, Tiranë.
2. T’i kërkojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, vendosjen e sanksionit administrativ.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

